



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04Nr. 111/01-90449 /2019
Kaçanik, 24.12.2019

Në bazë të nenit 5 pika (c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2018 Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, shpallë:

KONKURSIN E BRENDSHËM Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës i lëndës: Gjuhë Shqipe, me 10 orë
Institucioni: SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" Kaçanik
Kohëzgjatja e kontratës: me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që rregullojnë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të përgatisë me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës dhe të kryejë me përgjegjësi ekskursionet me nxënës brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të Shkollës;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ia caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi;

Kushtet e pjesëmarrjes në Konkurs :

Për vendin e punës për mësimdhënës, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it.Nr.10/2018 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin si në vijim: diploma e fakultetit përkatës, ekstrakti i lindjes, vërtetim për përvojën e punës në arsim, CV- në dhe kopjen e letërnjoftimit.

Procedura e konkurrimit: Të drejtë konkurrimi kanë vetëm të punësuarit të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

Afati dhe mënyra aplikimit.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendër për shërbim me qytetar-Zyra e Pranimit, kati përdhës.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes tabelës së shpalljeve publike.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Drejtoria e Drejtorisë
Z. Zahir Doda